



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin

PROCESVERBAL

Tiranë, më 13.03.2019, ora 9:00

Drejton mbledhjen:

Gramoz Ruçi – Kryetar i Kuvendit

Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi i vendimeve nr. 61 dhe nr. 62, datë 12.3.2019 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve “Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit kandidatit të listës shumemërore të Partisë Demokratike, të Shqipërisë në qarqet Kukës dhe Korçë për plotësimin e vakancave të njoftuara nga Kuvendi i Shqipërisë, si dhe verifikimi i mandatit të deputetëve z. Alban Zeneli dhe z. Ligoraq Karamelo.

Marrin pjesë:

Gramoz Ruçi, Vasilika Hysi, Klotilda Bushka, Ermonela Felaj (*zëvendësuese*), Musa Ulqini (*zëvendësues*).

Mungojnë:

Damian Gjikhuri, Ulsi Manja

HAPET MBLEDHJA

Gramoz Ruçi – Fillojmë mbledhjen e sotme të Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin.

Nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve janë depozituar në Kuvend vendimet për dhënien e mandatit të deputetëve të kandidatëve të listës shumëemërore të Partisë Demokratike të Shqipërisë, në qarqet Kukës dhe Korçë.

Në mbështetje të nenit 13 të Rregullores, Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin mblidhet për të bërë verifikimin e mandatit të deputetit që zgjidhet gjatë legjislaturës. Kanë fituar mandatin e deputetit, konkretisht:

- z. Alban Zeneli shpallur deputet i Kuvendit të Shqipërisë, vendimi nr. 61, dt. 12.3.2019 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve,

- z. Ligorag Karamelo shpallur deputet i Kuvendit të Shqipërisë me vendim nr. 62, dt. 12.3.2019, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve,

Siç jeni në dijeni, si rezultat i dorëheqjeve të deputetëve të opozitës, nga mandati i deputetit, mbështetur në nenin nr. 164 të Kodit Zgjedhor, Kuvendi i është drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për të njoftuar për vakancat e krijuara.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimet, nr. 61, nr. 62 i ka dhënë mandatin deputetëve vijues të listave respektive. Vendimet dhe raportin i keni të gjithë përpara.

A ka ndonjë mendim, ndonjë vërejtje apo ndonjë sugjerim nga anëtarët e Këshillit, në lidhje me mandatin e deputetëve të ri?

Nuk ka.

Atëherë, jemi dakord!

Anëtarët e Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin janë dakord me vendimet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe me konstatimin se mandati i deputetëve nuk ka paligjshmëri.

T'u shpërndahet deputetëve në seancë!

Znj. Klotilda Bushka të paraqesë në seancë raportin, siç është rregulli, që shpreh këtë qëndrim të Këshillit, i cili do të votohet nga seanca.

Të thirren deputetët e rinj për të bërë betimin.

Mbledhja mbyllet.

MBYLLET MBLEDHJA